



REPUBLIKA E SHQIPËRISE
**MINISTRIA E ARSIMIT
DHE SPORTIT**

Zhvillimi profesional i mësuesve nga Lugina e Preshevës

2017-03-29 10:24:00



Për herë të parë, nga Ministria e Arsimit dhe Sportit u organizua në Durrës, më datat 25-26 mars 2017, trajnimi profesional i rreth 90 mësuesve nga Lugina e Preshevës në fushat e gjuhës shqipe, historisë, trashëgimisë kulturore dhe arteve.

Tema si “Gjuha shqipe, rëndësia, metodologji të mësimdhënies”, “Edukimi për trashëgiminë në kurrikulën e arsimit parauniversitar”, “Të lexuarit, çelës për suksesin e nxënësit në shkollë dhe në jetë”, etj, u shtjelluan për pjesëmarrësit nga emra të njohur të fushës si Prof.Dr. Mimoza Gjokutaj, Prof. Dr.Fatmira Rama, ekspertët e Izha-s Albana Markja, Majlinda Halaj, Ines Todhe dhe Erida Koleci.

Gjithashtu, këta mësues patën mundësinë të ndajnë me kolegë të tyre në Shqipëri përvojat dhe eksperiencat si dhe sfidat me të cilat ndeshen ata në punën e përditëshme.

Pjesëmarrësit në trajnim u përshëndetën nga drejtues të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit si dhe të institucioneve të varësise.

Z.Agim Leka, Këshilltar në MAS, në fjalën e tij përcolli urimet e ministres së Arsimit dhe Sportit, znj.Lindita Nikolla si dhe shprehu mbështetjen për mësuesit e Luginës së Preshevës, mbështetur në nevojat e tyre.

“Falë jush dhe kontributit tuaj, fëmijët e trojeve shqiptare mësojnë identitetin e origjinës së tyre, gjuhën shqipe, gjeografinë, historinë, traditat tona zakonore. Ju falënderojmë për praninë tuaj, shprehim mirënjohje dhe respekt për përkushtimin në punën tuaj. Jemi të hapur ndaj bashkëpunimeve për të siguruar cilësi, profesionalizëm në institucionet arsimore të Luginës së Preshevës”.

Z.Gerti Janaqi, drejtor i IZHA-s, në fjalën e tij solli në vëmendje nismat e ndërmarra nga MAS për organizimin e disa seminareve për mësuesit shqiptarë në diasporë dhe u shpreh besimplotë se edhe ky aktivitet ndikon në ngritjen dhe zhvillimin profesional të mësuesve të Luginës së Preshevës, duke synuar rritjen e cilësisë arsimore në komunat shqiptare në Serbi dhe ruajtjen dhe kultivimin e vlerave kombëtare.

Z. Agim Hasani, drejtor i qendrës arsimore në komunën e Bujanocit, koordinator për aktivitetin, në fjalën e tij, falenderoi shtetin shqiptar dhe vecanërisht ministren e Arsimit dhe Sportit Znj. Lindita Nikolla, që mundësuan për herë të parë organizimin e këtij trajnimi për mësuesit shqiptarë nga Komunitat e Preshevës, Bujanocit dhe Medvegjës.

“Ky seminar ka efektin e tij, në ngritjen profesionale të këtyre mësuesve, tha z.Hasani, duke e cilësuar aktivitetin “100% të suksesshëm”. Kemi nevojë që trajnime të tilla të zhvillohen edhe në të ardhmen, theksoi ai.

Në përfundim të trajnimit mësuesit plotësuan edhe një pyetsor, ku një zëri shprehën mirënjohje dhe vlerësime për aktivitetin si dhe sugjeruan zhvillimin e aktiviteteve të tilla edhe në të ardhmen, trajnime interaktive dhe praktike, të shoqeruara me vizita në shkollat shqiptare. Mësuesit e Luginës së Preshevës u pajisën me certifikata nga Ministria e Arsimit dhe Sportit.

Organizimi dhe zhvillimi i këtij aktiviteti ordhi pas një takimi që

ministrja e Arsimit dhe Sportit, Znj.Lindita Nikolla, zhvilloi në shkurt të këtij viti në Tiranë me deputetin shqiptar të Luginës së Preshevës, në Parlamentin e Serbisë, z.Fatmir Hasani.